



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 107, datë 30.09.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.600.000 LEKË PËR OBJEKTIN  
“STUDIM PROJEKTIM PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “ADRIA” NGA  
ROTONDA E URËS SË DAJLANIT DERI TEK ROTONDA PRANË STACIONIT TË  
TRENIT”, KURSYER NGA PROCEDURA E PROKURIMIT ME OBJEKT  
“RIKONSTRUKSION RRUGA PAPA KLEMENTI I DYTË”**

Në zbatim të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 3 600 000 lekë për objektin “Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës “Adria” nga Rotonda e Urës së Dajlanit deri tek Rotonda pranë Stacionit të trenit”.
2. Fondi prej 3 600 000 lekë do të merret nga kursimet e procedurës së prokurimit publik të objektit “Rikonstruksion Rruga ”Papa Klementi i Dytë”, i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Vlera e projektit	Vlera sipas kontratës së nënshkruar pas procedurës së prokurimit publik	Vlera e kursyer
Rikonstruksion Rruga Papa Klementi i Dytë	22.000.000 lekë	12.594.420 lekë	9.405.580 lekë

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” rindryshuar).




### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.10.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 754 / prot.

Durrës, më 07.10.2021



**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK** ✓  
**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.107 datë 30.09.2021 Për miratimin e përdorimit të fondit prej 3.600.000 lekë për objektin “studim projektim për rikonstruksionin e rrugës “Adria” nga rotonda e urës së dajlanit deri tek rotonda pranë stacionit të trenit”, kursyer nga procedura e prokurimit me objekt “rikonstruksion rruga Papa Klementi i dytë”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

